



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XXXV-të (tridhjetepesë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 04 korrik 2025

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë:

znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, znj.Fikmete Qurkolli, z.Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Arbresha Bashota-zyrtare në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Driton Shabani, Adil Aliu dhe Astrit Rexhepi nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Zita Rasztk dhe Benjamin Bognar përfaqësuese të KFOR-LMT.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, për gjendjen socio-ekonomike, me theks të veçantë gjendja banimit dhe strehimit të familjeve të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, nga sektori i strehimit

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, si duket ndoshta paksa i kemi lodhur edhe zyrtarët e Drejtorisë së shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me këto tema apo çështje që kanë të bëjnë me komunitetin jo shumicë, mirëpo situata që jemi nganjëherë po na e imponon që të kemi informata më shumë nga kjo Drejtori si dhe të ngrisim edhe situata dhe çështje të ndryshme ngase qytetarët e komunitetit jo shumicë po vinë tek ne dhe po i paraqesin problemet, nevojat dhe shqetësimet e tyre kurse ne po u themi që të mos shkojnë në Komunë sepse do t'i paraqesim në mbledhje të Komitetit, kështu që në disa raste më mirë është kjo mënyrë sesa të vijnë drejtpërdrejt në Komunë dhe tek ju si Drejtori.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare në DSHMS Podujevë, theksoi, fillimisht ju them se asnjëherë nuk na boni telashe sepse kjo është punë e jona si zyrtar/e që jemi dhe atë për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës, dhe sa herë që dëshironi ne ju japim informata, sqarime dhe mundohemi t'ju dalim në ndihmë me ato mundësi që kemi si dhe gjithëherë jemi të gatshëm për vizita, ndihmë për plotësimin e dokumentacioneve të ndryshme dhe për çështje të tjera çka do që ka nevojë komuniteti jo shumicë në këtë rast.

Lidhur me çështjen e banimit jemi në dijeni se nuk është gjendja e mirë tek një pjesë e komunitetit jo shumicë, ka mungesë të pronës, pastaj janë kallaballëk familjarë nëpër shtëpi ku jetojnë dhe ne i kemi vizituar pothuajse të gjithë.

Çështja tjetër është që ne kemi aplikuar në Ministri me një projekt tjetër që është banimi i përballueshëm, projekt i cili tani veç ka filluar dhe do të jetë për qifte të reja, pra janë 133 banesa për qifte të reja dhe raste sociale që do të ndahen 30% me 70%.

Projekti tjetër që kemi aplikuar në Ministri është projekti për banimin social ku bëjnë pjesë renovimet dhe ndërtimet e shtëpive për komunitetin jo shumicë në lokalitetet ku kanë pronën familjet përkatëse. Vlen të theksohet se ne kemi dërguar listat e aplikantëve në Ministri ku janë edhe familjet e komunitetit jo shumicë dhe jemi në pritje të miratimit të këtij projekti, posaçërisht janë ato familje që kanë pronë dhe që janë duke jetuar në një gjendje shumë të rëndë të banimit dhe tani vetëm po presim përgjigje prej Ministrisë.

Besoj se do të kemi raste edhe për renovim të shtëpive e që është një numër i atyre që kanë aplikuar ku komisioni përkatës ka dalë dhe ka vizituar, e që ne së bashku me shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri i dim pothuajse të gjitha rastet sepse i kemi vizituar dhe presim që së shpejti do të fillohet me renovim ose ndërtim të shtëpive për ato raste.

Sa i përket ndihmave për barna, ne si drejtori për çdo muaj jemi duke shqyrtuar aplikacione e që ka edhe nga komuniteti jo shumicë e që natyrisht se ju japim rëndësi dhe vazhdimisht mundohemi të fokusohemi tek ato rastet që janë më të rënda siç janë me kancer, leukemi e të tjera, por që tek komuniteti jo shumicë vazhdimisht mundohemi t'i përfshijmë edhe disa prej rasteve që janë më të lehta, jo vetëm rastet e rënda siç i ceka.

Sa i përket ndihmave me pako ushqimore, po ashtu jemi duke u munduar që sa herë që kemi donatorë, t'i përfshijmë të gjithë, tani së fundmi kemi ndarë mish dhe jemi kujdesur që të përfshijmë sa më shumë familje të komunitetit jo shumicë.

Besoj se i përmenda të gjitha më kryesoret që kisha për të thënë, përndryshe çka do që ka ne këtu jemi dhe mund t'ju informojmë, sqarojmë dhe t'ju japim përgjigje sa i përket kësaj teme.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësen për këto të dhëna. T'ju them të drejtën barrën kryesore jeni duke mbajtur ju sepse vërtetë keni shumë punë, kërkesa, ankesa dhe shqetësime të qytetarëve duke përfshirë edhe komunitetin jo shumicë. Edhe unë si kryesues i këtij Komiteti dhe si përfaqësues i një pjese të komunitetit jo shumicë vërtetë kam shumë kërkesa, ankesa dhe çështje të ndryshme nga komuniteti ku nganjëherë t'ju tregoj të vërtetën që ka raste që i'u them familjarëve t'ju thonë që nuk jam në shtëpi sepse vërtetë jam i lodhur me këto gjëra dhe nuk kam çfarë t'iu ndihmoj përveç që t'i paraqes të njëjtat në këtë Komitet dhe disa prej tyre t'i adresoj nëpër Drejtoritë përkatëse.

Ne jemi në dijeni se pa pasur konkurs, pa pasë thirrje për aplikim dhe mbledhje, ne nuk mund t'i dorëzojmë, mirëpo qëllimi është që ato raste për të cilat jemi në dijeni ne po i tregojmë dhe po i adresojmë tek organet dhe institucionet përkatëse, por më shumë diçka nuk mund të bëjmë në këtë aspekt sepse nuk kemi kompetencë më shumë.

Përndryshe ju falënderoj dhe ju përgëzoj për punën e bërë si zyrtare dhe DSHMS, si ZKKK dhe si Komunë në përgjithësi gjatë kësaj kohe.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare në DSHMS Podujevë, theksoi, po ashtu edhe një informatë shtesë për komunitetin jo shumicë, Ministria sërish do të bëjë shpalljen për aplikim për shtëpi dhe renovime e që ne do t'ju informojmë për këtë dhe do t'ju inkurajojmë dhe ndihmojmë të aplikoni, edhe pse ende nuk jemi në dijeni se çfarë saktësisht do të jetë ajo shpallje por ne jemi këtu dhe do të bashkëpunojmë në këtë aspekt qoftë dhënien e ndihmës në plotësimin e aplikacioneve, qoftë sqarime, qoftë aplikim e të tjera çfarëdo që do të ketë nevojë duke përfshirë edhe librezat e socialit dhe gjithë dokumentacionin tjetër të nevojshëm.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, siç u cekë më herët nga parafolësja, ne me shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri kemi vizituar familjet e komuniteteve jo shumicë ku edhe kemi bërë edhe foto nga ato vizita dhe të atyre shtëpive, foto të cilat i posedon zotëri Zeqiri dhe që mund t'i dokumentojmë si dëshmi që vërtetë familjet e komunitetit jo shumicë në ato vende që kemi qenë ka nevoja të shumta për rregullim të shtëpive sepse vërtetë ka nevojë ngase ndërtimet ekzistuese janë në prona të vogla kështu shpeshherë po ka edhe probleme familjare qoftë për social qoftë për aspekte tjera sepse ka raste dhe jo të pakta që janë dy e familje në një shtëpi ose nën një kulm.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, duke përshëndetur të gjithë të pranishmit, theksoi, unë gjithëherë kamë qejf të flas me fakte, dokumente dhe dëshmi.

E përshëndes shumë zyrtaren e DSHMS dhe atë jo që është këtu prezentë por vërtetë për punën, volumin dhe aspektin e aftësisë e cila nuk ka hezitur asnjëherë t'iu dalë në ndihmë komuniteteve jo shumicë si dhe bashkëpunimin që kemi vazhdimisht me të dhe DSHMS e cila ndahet në shëndetësi por edhe në çështjet sociale ku bënë pjesë edhe strehimi.

Unë çështjen e strehimit e kam komentuar dhe e kam biseduar shumë qoftë edhe në nivele më të larta shtetërore që ato që u cekën nga zonja Arbresha dhe nga Kryesuesi është legalizimi i pronave të familjeve të komuniteteve jo shumicë, problem ky i cili është edhe më i gjerë sepse tani mund t'ju them shembull se unë nuk e kam pronën time në emër timin edhe pse jemi shumicë dhe nuk i kemi pronat ë emër tonin, mirëpo të paktën duhet të jetë që pronat të përputhen në mbiemrin e atyre që janë aty apo në emër të babës, babagjyshit, katragjyshit, stërgjyshit, sepse pastaj po na sjellin vështirësi dhe mandej po duhet të shkohet te Noteri dhe të verifikohen ato gjëra.

Pra këtë e kam kërkuar edhe tek Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, edhe te Ministria për Komunitete dhe Kthim, pra kam kërkuar që të hiqet kjo temë sa i përket legalizimit të pronave. Që të mos jetë kusht që ai që nuk e ka pronën mbi vete, por nëse ajo pronë është e babës, babagjyshit, katragjyshit të tij, të anashkalohet kjo në mënyrë që të vije tek aplikimi dhe përfitimi i projekteve të strehimit, renovimit apo ndërtimit të shtëpive sepse janë jetike për njeriun, dhe këtë e them edhe duke qenë në dijeni për gjendjen faktike të një pjese të komuniteteve jo shumicë sepse siç e ceku edhe Kryesuesi ne kemi vizituar dhe kemi parë nga afër gjendjen e çdo familje familjeve të komuniteteve e që tani ju them në mënyrën më të sinqertë se jam duke u munduar me mund dhe me shpirt sa i përket strehimit dhe banimit si çështje shumë të ndjeshme ngase ka raste që u cekën që jetojnë në hapësira të vogla e që kërkesat e tyre janë që të bëjnë mbindërtim sepse nuk kanë hapësira ose prona tjera, pastaj ka raste ku në një familje ka mosmarrëveshje në kuptimin që banojnë në hapësira të ngushta dhe janë këto çështje për të cilat ne e kemi edhe për obligim t'iu ndihmojmë me tërë fuqinë dhe mundin që kemi.

E di që Komuna e Podujevës çdo herë ka qenë gatshme, duke filluar prej Kryetarit të Komunës dhe çdo dikaster tjetër duke përfshirë edhe neve që jemi këtu tani, për t'iu ndihmuar për të bërë zgjidhje, madje për këtë është në dijeni edhe Kryesuesi i këtij Komiteti z.Xhafer Ademi që unë edhe më parë kam kërkuar pronë publike që të jetë e destinuar për raste të rënda ekonomike dhe që nuk kanë pronë të veten për të ndërtuar shtëpi, e që dihet se janë procedura për këtë çështje që kalojnë përmes Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, asamblesë komunale e të tjera që

janë vendime që nuk janë të lehta për tu marrë, por që kërkesa ka qenë që të gjendet diku një pronë për ato raste që vërtetë janë në një gjendje jo të mirë qoftë ekonomike, pronësore dhe sociale, Megjithatë për këto që janë aktuale, siç e potencoj edhe parafolesja znj.Arbresha Bashota që do të minohemi t'iu ndihmojmë në aplikacione e ët tjera, por do ta ngrisim zërin edhe më lartë qoftë te donatorët, qoftë te niveli qendrorë në mënyrë sa do pak ta stabilizojmë gjendjen aktuale sa i përket banimit dhe strehimit të qytetarëve të Komunës së Podujevës, me theks të komunitetit jo shumicë, rasteve që kanë nevojë më shumë sepse këtë e kemi edhe detyrë e që do të angazhohemi dhe mundohemi qoftë unë si ZKKK, qoftë znj.Arbresha Bashota si zyrtare përkatëse në DSHMS, Kryetari i Komunës dhe të tjerët që t'iu ndihmojmë aq sa kemi mundësi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, këto që i potencoj parafolesë zotëri Zeqiri janë gjëra që i kemi parë dhe jemi të njoftuar me to, çka do që mundemi do të bëjmë të gjithë bashkërisht, çka nuk mundemi nuk kemi çfarë të bëjmë më shumë, kështu rreth kësaj teme u diskutua dhe besoj u sqaruan dhe u dhanë informatat e nevojshme, andaj nëse nuk të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, e konsideroj të përfunduar këtë ikë të rendit të ditës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

2. Informatë e Shefit të ZKKK-Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, për hartimin e udhëzuesit për zbatimin e planit të veprimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, nga punëtorja e mbajtur nga ZKQM-ja dhe MAPL-ja

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, në cilësinë e pozitës që jam, kam qenë në një punëtorë për 4 ditë në Durrës dhe 2 ditë në Prevalë dhe tema ka qenë krejt këto çështje që i biseduam deri tan që është Plani i veprimit për të drejtat e komuniteteve, apo të themi më mirë për avancimin e të drejtave të komuniteteve në fusha të ndryshme që enkas tema janë për avancim, jo për integrim, dhe ato që janë temat kryesore kanë qenë arsimi, shëndetësia, edukimi, kultura, strehimi, banimi, infrastruktura, mediat, shoqëria civile dhe të gjitha këto tema të themi të drejtën unë për Komunën e Podujevës i kam dhënë saktë të dhënat qoftë të banorëve sa janë, qoftë komuniteteve, qoftë gjendjen faktike për të gjitha këto fusha që i ceka dhe jemi prej Komunave që, nuk po e them për tu lavdëruar, por që e kemi hartuar Planin e tretë të veprimit për avancimin e komuniteteve jo shumicë, pra kanë qenë Plani i veprimit 2016-2020 për integrimin e komuniteteve RAE, pastaj Plani i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë 2020-2023, si dhe Plani i veprimit 2023-2026, dhe në bazë të referencave që kemi pasë dhe 2 Udhëzimeve Administrative për këtë fushë, normale që edhe Qeveria ka avancuar në aspektin e strategjike sa i përket avancimit të të drejtave të komuniteteve jo shumicë, dhe në bazë të Strategjisë që është baza themelore në krijojmë edhe Plane të veprimit në nivele lokale sepse për nivelin nacional është Qeveria e cila merret me këto çështje siç është Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që dua të them se është komunikimi dhe lidhja jonë direkte në kuptimin horizontal dhe vertikal, pra në kuptimin horizontal jemi ne si ZKKK që koordinojmë të gjitha punët me të gjitha zyrat që janë këtu që merren me këto çështje, kurse kuptimi vertikal është niveli më i lartë që nga Kryetari i Komunës, Nënkyetarija e kështu me radhë.

Në emër të ZKKK unë i kam paraqitur ato koordinimet dhe komunikime tona dhe për këto çështje kam qenë optimist sepse ka shumë Komuna që nuk i kanë këto zgjedhje e që ndoshta i'u mungon komunikimi dhe vullneti dhe ndoshta edhe motivi i punës, e që ne në Komunën e Podujevës në këtë aspekt qëndrojmë shumë mirë dhe për këtë mendoj se ne jemi në shërbim të të gjithë

qytetarëve dhe normale që duhet të jemi pakë më të përkushtuar, të paktën ne si ZKKK, për komunitetet jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës.

Duke parë këto analiza që janë bërë, kanë qenë prezentë nga MAPL, nga Organizata të ndryshme dhe në ato takime në rend të ditës ka qenë tema e cekur e që shembull janë marrë dy Komuna për këto aktivitete, Komuna e Podujevës dhe Komuna e Novobërdës, dhe në kuadër të kësaj unë kam mbajtur një seancë për rreth 30 minuta ku i kam shpalosë të gjitha avancimet e Komunës tonë dhe atë me fakte mirëpo natyrisht se kam pasë edhe shqetësimet tona sepse nuk jemi gjithçka perfekt sepse janë edhe ato anët tjera që nuk po mund t'i kryejmë apo që jemi në mundim e sipër për t'i kryer siç janë çështja e banimit, strehimit, infrastrukturës, pastaj kam diskutuar edhe për çështjen e ujësjellësit e cila është çështje paksa delikate dhe jemi ë dijeni se qysh tani për momentin nuk keni ujë të pijes në disa lagje ku jetojnë edhe komuniteti jo shumicë sikurse që është ky problem edhe në shumë fshatra tjera për çka arsyet nuk i di në tërësi por e di që është kompani publike e ujësjellësit e cila nuk i jep llogari Komunës por që ka një bashkëpunim me Komunën sepse siç dihet KEDS dhe Ujësjellës janë kompani profitabile që arkëtojnë edhe të hyrat e veta, por që normale se si shtet duhet të ketë bashkëpunim në mes institucioneve sikurse që është bashkëpunimi e kompaninë e Pastrimit.

Pra jam munduar të shfaqë shqetësimet e të gjithë banorëve, por më së shumti atyre të komuniteteve jo shumicë. Tani Udhëzimi administrativ është në hartim e sipër për të cilin është ngritur edhe Grupi punues. Ne më 28.02.2023 ne e kemi themeluar Komitetin Komuna Veprues dhe në kuadër të këtij Komiteti janë dikasteret kryesore arsimit, shëndetësia, Qendra për Punës Sociale dhe të gjitha dikasteret tjera kryesore si dhe Shoqatat përkatëse të shoqërisë civile, andaj në bashkëpunim me të gjitha këto normale që duhet të jemi sa më afër qytetarëve dhe të mund t'iu dilet në shërbim të tyre për nevojat që kanë, në kuptimin e gjerë po foli, me theks të veçantë po e them që duhet të jetë dikush që e ngritë zërin aty ku duhet, qoftë në Komunë, qoftë në Qeveri, tek donatorët për të gjitha këto problemet që janë të nevojshme për të bërë zgjidhje.

Unë jam i gatshëm çdo herë sikurse që jemi të gatshëm gjithë Komuna e Podujevës që ë gjitha shqetësime dhe nevojat e komuniteteve sa më shumë të jetë e mundur t'i zvogëlojmë dhe t'i ndihmojmë të gjithëve në forma të ndryshme.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ju falënderoj i nderuar zotëri Zeqiri për të gjitha këto informacione dhe prezantime që ke bërë në ato takime.

Unë vetëm një shembull po dua t'ju tregoj se kam qenë në një trajnim ku kemi konkurruar për një projekt për komunitetin RAE në Komunën e Podujevës e që në bazë të Planit të Veprimit që u cek e që unë e kam marrë me vete sepse e kam ditë në një mënyrë se ndoshta do të hyn në punë, ka qenë i nevojshëm për tu shpall përfitues i projektit i cili ndërlidhet me nxënësit e komunitetit RAE që do të organizohet me Organizatën Jo Qeveritare "Edu Courses" në bashkëpunim edhe me Organizatën që unë drejtoj, ku jemi bashkuar si dy Organizata për realizmin e atij projekti për nxënësit e komunitetit RAE të cilët së bashku me nxënësit e komunitetit shumicë e që vërtetë besojmë se do të kalojnë mirë në një kamping veror që do të mbahet duke mbajtur edhe ligjërata, informime të ndryshme dhe trajnime për fusha të ndryshme.

Urdhëroni nëse ka nderuar të interesuar për të marrë fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e përfundojmë edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

3. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës unë shfrytëzoj rastin të falënderoj Policinë e Kosovës në Komunën e Podujevës të cilët gjatë konkursit për aplikim në Policinë e Kosovës, kanë dhënë informata dhe janë angazhuar t'i informojnë pjesëtarët e komunitetit jo shumicë për të aplikuar, kështu që bashkërisht kemi vepruar në shpërndarjen e informatave duke i informuar gjithë komunitetin jo shumicë e që nga komuniteti jo shumicë kanë konkurruar dy persona për momentin aq sa kam informata unë.

Po ashtu ne komuniteti jo shumicë që jetojmë në rrugën "Ali Ajeti" kemi një shqetësim shumë të madhe që është mungesa e ujit në atë rrethinë dhe jemi në gjendje katastrofale dhe në gjendje shumë të rrezikshme për shfaqjen e ndonjë sëmundje për çka unë personalisht shumë jam duke pasë frikë se do të ndodhë. Pra gypat janë ata që janë e që vazhdimisht kemi kërkuar të ndërrohen, mirëpo tani nuk ka ujë fare, asnjë makinë e larjes së rrobave nuk përdoret, as nuk kemi fare ujë për tu pastruar, përveç atyre që bëjnë zgjidhje me bidonë duke e nxehur ujin për të mund të pastrohen.

Në këtë aspekt pra është shqetësim shumë i madh i komunitetit dhe meqë është edhe policia këtu përzentë vetëm po dëshiroj nga këta të më informojnë rreth afatit të lajmërimit të protestës sepse kam presion të madhe nga komuniteti jo shumicë dhe jo vetëm për organizmin e një proteste.

Pra sa kohë përpara duhet të lajmërohet policia për protestë sepse ne nuk mund të qëndrojmë më në këtë gjendje. Sa për informimin e juaj ne kemi qenë të lidhur në rrjetin e qytetit të Podujevës ku të paktën natën kemi pasë ujë, kurse tani na kanë kaluar në rrjetin e fshatrave dhe nuk kemi fare as natën as ditën, vie 5 deri në 10 minuta uji sa për të mbushur një shishe dhe ndalet.

Është kallaballëk i madh në atë lagje sepse si lagje është e madhe dhe nuk janë vetëm komuniteti jo shumicë por ka edhe nga komuniteti shumicë të cilët kanë ardhur tek unë si përfaqësues i komunitetit RAE por edhe si Kryesues i këtij Komiteti dhe po duan të dalin protestë para ujësjellësit sepse nuk mund të qëndrojmë më, ka rreth 1 muaj që jemi në këtë gjendje, për 1 ditë e 1 javë ndoshta do të kuptonim sepse mund të ndodhin prishje e çështje të ngjashme.

Kam frikë që do të shfaqen sëmundje të ndryshme nga ajo gjendje që jemi, mund të shfaqet sëmundja e zgjebes siç njihet zhuga sepse pa u pastruar, pa pastruar rrobat dhe asgjë fare sepse është shumë rrezik i madh, aq më shumë në këtë kohë kur po ka vapë të madhe. Për ujë të pijes po bëhen zgjidhje sepse po blihen nga familjet, por për pastrim dhe nevoja tjera siç i dimë të gjithë nuk po mund të bëjmë zgjidhje. Kështu që edhe njëherë po e përsërisë dhe po kërkojë një përgjigje nga Policia që më informojë sa kemi kohë përpara dhe ku duhet të vijmë të paraqesim kërkesën për protestë.

z.Driton Shabani, zyrtar policor në Stacionin Podujevë përkatësisht koordinators për sektorë dhe komunitet në Stacionin e Policisë në Podujevë, duke i dhënë përgjigje parafolësit falënderimin që bëri për Policinë, si dhe për shqetësimin dhe pyetjen e paraqitur, theksoi, fillimisht neve na vie keq për shqetësimin e juaj konkretisht mungesës së ujit në lagjen / rrugën e cekur, kurse sa i përket organizimit të protestës lajmërimi në Polici duhet të bëhet 72 orë përpara ku nga organizatori/ët sjellët një kërkesë në Stacionin e Policisë të Podujevës ku ne pastaj duhet të marrim një leje në Regjionin e Prishtinës e që faktikisht sipas të gjitha gjasave ajo kërkesë aprovohet prej Policisë për të ofruar ne siguri gjatë mbajtjes së protestës. Do të thotë ju e sjellëni kërkesën / njoftimin në formë të shkruar në Stacionin e Policisë dhe ajo kërkesë sipas të gjitha gjasave aprovohet.

Sa i përket konkursit për pranim në Polici që u çek nga Kryesuesi i Komitetit, ne do të thotë vetëm kemi dhënë kontributin tonë në të gjitha lagjet dhe lokalitetet ku jetojnë komuniteti jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Njëkohësisht ju informoj sërish rreth kësaj çështje që konkursi është i hapur deri të hënën më 07.07.2025 dhe kush do që dëshiron mund të aplikoj dhe kushdo që ka vështirësi në aplikim qoftë përmes platformës E-Kosova qoftë aplikim në mënyrë fizike mund të vijnë në Stacionin e Policisë dhe të kërkojnë ndihmë dhe ne do t'ju ndihmojmë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin nga Stacioni i Policisë në Podujevë për ndihmë e dhënë komunitetit jo shumicë në këtë çështjen e konkursit dhe aplikimit për çka thënë të drejtën interesimi i tyre ka qenë i madh për inkurajim të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë për pjesëtar të Policisë së Kosovës kështu që komuniteti jo shumicë nuk ka mbet për asgjë që të konkurrojnë, ata që dëshirojnë të konkurrojnë ende paskan afat dhe nëse duan të aplikojnë mund ta bëjnë, nëse nuk kanë informata apo njohuri rreth aplikimit dhe dokumentacioneve tjera mund të drejtohen në Stacionin e Policisë për të marrë ndihmën e nevojshme ashtu siç e ceku edhe parafolësi.

Po ashtu falënderoj parafolësin për informatën e dhënë sa i përket lajmërimit dhe paraqitjes së është për organizimin e protestës. Tani mua më duhet ta informoj komunitetin e interesuar në lagje sepse duke më pritur janë që të jap këtë informatë, madje disa prej tyre kanë pasë të vijnë këtu në Komunës por disi i ndalova, por thënë të drejtën janë në hallë të madh dhe janë lodhur shumë nga kjo gjendje sepse nuk kanë rrugëdalje, pjesa më e madhe as nuk kemi bunare / pouse të ujit edhe pse edhe ata që i kanë po frikohen ta përdorin atë ujë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, unë e di këtë shqetësim tuajin sa i përket rrjetit të ujësjellësit dhe jo rastësisht e potencova pak më parë, mirëpo i nderuar Xhafer më datë 30.06.2025 ka qenë këtu në këtë sallë një dëgjim diskutim publik për 2 orë të tëra nga ora 10:00 deri në ora 12:00 ku ka qenë Kryetari i Komunës prezent, andaj është dashtë të vije dikush nga ju dhe t'i ngris këto shqetësime sepse ka qenë takim i hapur me qytetarë i thirrur nga Kryetari i Komunës. Unë kam qenë prezent në atë takim, nuk jeni vetëm ju që keni mungesë të ujit por si shqetësim është ngritur nga shumë fshatra siç ishte njëri prej tyre fshati Godishnjak për të cilin e ka ngritur një person me mbiemrin Visoka, pastaj ka pasë edhe nga fshati Dumnicë dhe nga rajonet tjera, madje problematika e njëjtë është edhe në fshatin ku jetoj unë sepse ka rënë niveli i ujit-shtypja. Pra shqetësimet kanë qenë shumë të mëdha nga ana e qytetarëve, Kryetari i Komunës është shprehë që do të mundohet me krejt fuqinë dhe autoritetin që ka që me Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" që të bëjë zbutjen e kësaj gjendje, marrë për bazë edhe temperaturën e lartë normale që e kanë ndalë edhe paksa shtypjen e ujit, probleme këto të cilat i kemi edhe si trevë dhe territor i Llapit që jemi, mirëpo ajo që është për t'u vlerësuar nga qytetarët është kjo ana perëndimore e Llapit që nuk kanë rrjet të ujësjellësit është mirë që tani është bërë fizibiliteti i një pende që do të ndërtohet në ato fshatra por që ajo punë sigurisht që donë kohë, por që kjo është mirë për qytetarët sepse problemi më i madh në Kosovë është çështja e ujit dhe kur e them në Kosovë dëshiroj të sqaroj edhe me fakte sepse si shtet që jemi Kosova nuk e ka asnjë rrjedhje prej shteteve tjera, por atë që e dredhojmë, akumulojmë dhe që e bjerim nëpër puse dhe në rrjet është e vetmja kjo dhe herët apo vonë do të jetë problemi më i madh uji i pijes. Po e them publikisht tani se po të mos ishte Ujëmani ose Gazivoda çka do të mund të bënim ne si Kosovë sepse kemi vetëm dy liqe të akumuluar që janë liqeni i Batlavës dhe liqeni i Badovcit, kur shteret Badovci uji vije prej Ujëmanit, dhe kjo është problematika që tani është tek organet më të larta shtetërore të nivelit më të lartë që janë bind në këtë shqetësim sepse duhet

bërë edhe zgjidhje tjera të akumulimit të liqeneve artificial, kurse ne falë Zotit e kemi këtë pjesën perëndimore të Llapit Pollatën.

Sigurisht që unë do t'ia jap këto informacione edhe Kryetarit të Komunës ose mund të shkojmë edhe bashkë i nderuar zotëri Xhafer, mirëpo nuk është zgjidhje të bëhen protesta sepse nuk është problem i vetëm një lagjeje që i është ndal uji sepse në atë lagje jetojnë edhe komuniteti shumicë, pra të mos i ndërlikojë temat sepse nuk është shqetësimi që ka diçka në kuptimin e diskriminimit ta quaj ashtu e që s'mund të ketë në këtë aspekt sepse uji, rryma, infrastruktura, shkollat, shëndetësia dhe të tjera fusha janë në shërbim të të gjithë qytetarëve, mirëpo ajo që është prezantuar me shuplaka/duartrokitje, për këtë çështje i'a kanë bërë 10 pyetje Kryetarit të Komunës në atë takim e që do të duhej të ishte edhe ti prezent zotëri Xhafer Ademi e përse nuk ke qenë nuk e di, por që Kryetari i Komunës e ka marrë këtë detyrë që sërish të përcjellë me mundësitë që ka sepse nuk munde më shumë ngase kompania e Ujësjellësit është kompani në veti dhe ne këtë e dimë, por Kryetari i Komunës mund të interferoj dhe të intervenoj dhe të komunikoj se qysh e ka gjendjen në Komunë qoftë te uji, qoftë te energjia, prandaj për këto shqetësime unë po ju jap fjalën tani që në emër të juve si komunitet do të bisedoj me Kryetarin e Komunës dhe mund t'ju bëjë një telefonatë dhe t'ju informoj për më të rejat, a mundem kështu i nderur Kryesues.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë atëherë po pres informatën tënde i nderur Liman Zeqiri. Singerisht e them se mua shumë keq po m vie por vërtetë kam shumë presion të madh nga komuniteti në atë lagje sepse ma kanë tepruar me kërkesa dhe nuk po di kah t'ia mbaj ngase ata pa mua po thonë që pa ty nuk dalim dhe nuk marrim iniciativë as organizim të protestës, kështu që edhe mund të veprojnë, përndryshe mua më vie keq singerisht sepse po e qesim një lloj hije të keqe Komunës, aq më shumë tan veç se janë shpallë zgjedhjet lokale dhe mund t'ju nxjerrim telashe, pra kjo është ajo që mua më ka shqetësuar më së shumti që mos po e dëmtojmë ndokënd në aspektin e zgjedhjeve dhe fushatës.

Po ashtu dëshiroj të jap edhe një lajmë që ka të bëjë me ujin apo rrjetin e ujësjellësit, projekti sot ose nesër do të filloj të ndërrohet gypi i ujësjellësit dhe do të bëhet rrjeti i ri i ujësjellësit në lagjen ku jetojmë komuniteti jo shumicë, për çka falënderoj të gjithë që kanë kontribuar në këtë projekt dhe posaçërisht e falënderoj Kryetarin e Komunës, po ashtu juve z.Liman Zeqiri që gjithëherë e kemi paraqitur bashkërisht si shqetësim, kështu që dje kanë qenë e kanë shikuar vendin se ku do të fillojnë me punime.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, edhe pse jam person që nuk kam qejf të flas shumë por kam qejf të punoj, mirëpo dua t'ju tregoj që më datë 18.08.2022 e kemi dorëzuar këtë projekt që e ceku Kryesuesi, dhe kemi dalë bashkë me Drejtorinë e Urbanizmit dhe me inxhinierët komunal ku i kemi bërë të gjitha matjet dhe analizat për këtë projekt sepse një gjë të tillë e ka kërkuar Ministria përkatëse për ta fut në planifikime sepse e kemi konsideruar projekt vital për Komunën dhe komunitetin jo shumicë. Pra ky projekt është nënshkruar nga Kryetari i Komunës më 18.02.2022 dhe është dorëzuar në nivel qendror por që nuk është aprovuar në atë kohë, por që pastaj atë punë e kam marrë përsipër Komuna sepse nuk ka qenë një shumë e madhe për realizmin e atij projekti 88,930.00€ dhe tani i gëzohem faktit që kanë përfunduar procedurat dhe po fillon të realizohet ai projekt që është shtrirja e rrjetit të ri të ujësjellësit në lagjen përkatëse në rr.Ali Ajeti", pra do të hiqet gypi aktual që është i azbestit dhe vendoset gyp i ri, prandaj kjo është një gëzim i madh për mua dhe për banorët e asaj lagjeje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë posaçërisht për këtë projekt e falënderoj Kryetarin e Komunës sepse nëse ju kujtohet i nderuar Zeqiri kur kemi qenë në një debat publik ju është kërkuar juve projekti dhe i'a keni dhënë për ta shikuar dhe analizuar atë projekt e që tani ka ardh

koha e realizmit të tij për çka i gëzohemi të gjithë, andaj edhe kjo është një ndër arsytet që po dua t'i ikim mbajtjes së protestës për mungesën e ujit.

znj.Fikmete Qurkolli, theksoi, Veli Halili në fshatin Dumnicë ka paraqitur kërkesë që 6 muaj për rregullimin e rrugës me zhavorr por ende nuk i është rregulluar. Shtëpia i është ndërtuar nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, andaj dëshiroj të njoftohem se a do të rregullohet ajo rrugë edhe pse drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit e potencoj në mbledhjen e kaluar e tha që ajo rrugë është shtruar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e vërtetë është që në mbledhjen e kaluar drejtori z.Bahri Selimi e tha që ajo rrugë është shtruar dhe këtu kemi qenë prezent të gjithë, por çka ka mund të ndodh atje nuk po mund ta di ani.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, personi i cekur ka qenë në takim tek unë për atë çështje. Ne e patëm mbledhjen paraprake më 08.06.2025 për të cilën ekziston edhe procesverbali ku prezent ishte edhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH i cili e ka fol për atë rrugë dhe për çështje tjera për çka e kemi ftuar në mbledhje.

Drejtori i DSHPMSH në atë takim ka thënë që në atë rrugë janë shtruar rreth 200 metra zhavorr dhe unë e kam ngritë si shqetësim për kanalizimin në atë rrugë dhe për atë familje të shtrohet edhe kanalizimi. Për këtë çështje unë kam qenë edhe te kjo Drejtori, por tani përse nuk është shtruar nuk e di, por e di që drejtori i DSHPMSH e pati potencuar që ajo rrugë është kryer.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e vërtetë është që drejtori i DSHPMSH e ka potencuar këtu në takimin paraprak që ajo rrugë është shtruar, mandej nuk di për këtë çështje.

Meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të mare fjalën, e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Konstatohet e përfunduar kjo mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0038072/25
Podujevë, 04 korrik 2025**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**